



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:246919
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05617414

KPPP.nr.1259/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Union” Sh.p.k me numër të biznesit 70035717 të cilin e përfaqëson avokat Naser Peci me seli në Prishtinë, kundër debitorit NPT “Carpet” me numër të biznesit 70057293, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Muhamet Shala me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.03/19 të datës 26.03.2019 të Përmbartuesit Privat Isak Islami me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit NPT “Carpet” dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.03/19 të datës 26.03.2019, i lejuar më datën 26.03.2019, nga Përmbartuesi Privat Isak Islami, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.03/19 të datës 26.03.2019, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë C.nr. 2418/15 të datës 06.11.2018, ku e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri të ndalohet ushtrimi i veprimtarisë afariste në njësin kadastrale P-... vendi i quajtur “Jagnello” sipërfaqe prej 2500 m², pronë e kreditorit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim ku e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se vendimi mbi bazën e të cilin është lejuar urdhri në ikën dy e obligon paditësin kundër të paditurinë që ti lejojë kundërshtarit të sigurimit NTP Carpet, që ta shfrytëzoj pjesën e ngastrës lëndore si biznes individual, në sipërfaqe formë dhe destinim të cilin

deri më tani e ka shfrytëzuar, në kohëzgjatje deri në vendosje meritore të çështjes, meqenëse palët për palujtshmëri të cilën kërkohet të ekzekutohet vendimi janë duke zhvilluar procedurë kontestimore lidhur me vërtetimin e pronësisë, më tej shtuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore pasi që debitori është në shfrytëzim të kësaj pjese të paluajtshmërisë si bashkëpronarë gjatë procedurës së privatizimit, e si pasoj kjo palujtshmëri figuron në emër të kreditorit pasi që nuk është bartur në emër të këtui debitorit pjesa për të cilën ka kontribuar në privatizimin e së njëjtës. Në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tersi si i bazuar parapësimi ndërsa urdhri përmbarrimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pa bazuara, pasi që nuk janë të bazuar në nenin 70 të LPP-së, i njëjti nuk i ka saktësuar shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi dhe çdo prapësim i cili nuk përmban shkaqet e theksuara në dispozit do të duhet të trajtohet si i pa lejuar. Më tej ka shtuar se organi përmbarrues ka caktuar përmbarrimin mbi bazën e dokumentit përmbarrues, aktvendimi i gjykatës përmban detyrim, detyrim ky i cili nuk është përmbushur vullnetarisht, meqenëse debitori refuzon përmbushjen e detyrimit në afatin vullnetar, atëherë kreditori ka iniciuar procedurë përmbarrimore sipas dokumentit përmbarrimor, pos tjerash i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit ndërsa urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata në ri procedurë duke i pasur parasysh sugjerime dhe vërejtje të Gjykatës së Apelit sipas vendimit AC.nr.3693/20 të datës 13.08.2021, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Në rastin konkret rezulton se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në Akendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë C.nr. 2418/15 i datës 06.11.2017 me të cilin në pikën I është detyruar këtui debitori të ndalohet shfrytëzimi i më tej më i objektit egzistues të vendosur në njësinë kadastrale P-... në sipërfaqe prej 2500m2 tokë bujqësore, ndërsa në pikën II obligohet këtui kreditori që ti lejojë këtui debitorit që në shërbim të biznesit të tij ta shfrytëzoj pjesën e ngastrës lëndore njësinë kadastrale P-..., në sipërfaqe dhe formë destinim deri më tani deri në përfundimin meritor të kësaj çështje kontestimore.

Gjykata gjeti se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbarimit, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 i cili përcakton “*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” dhe nenit 36 par. 1 i cili përcakton se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti përmbarimor – Akendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë C.nr. 2418/15 i datës 06.11.2017, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarim të përcaktuara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e ekzekutueshmërisë, me çka rezulton se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat nuk i plotëson kushtet për përmbarim që duhet t’i ketë dokumenti përmbarimor, të parapara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1259/22, datë 24.04.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.